

## Njoftim

Sot, më datë **07.06.2023**, ora **08:30**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Alma Kolgjoka (Relatore);**
- 2. Emona Muçi (Anëtare);**
- 3. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 4. Esmeralda Xhili (Anëtare);**
- 5. Marsela Dervishi (Anëtare);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr.“Ismaïl Qemali”, Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen Nr.27 Regj.Themeltar, Datë 05.06.2023 Regjistrimi, me:

**Paditës:** Partia Aleanca Progresiste, LZHK, përfaqësuar nga Av. Rizaldo Vrenozi.

**Të paditur:** Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve;

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

**Objekti:** 1. Ndryshimin e Vendimit të Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve nr.160, datë 29.05.2023, për shqyrtimin e kërkesës nr.74, datë 17.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili ka vendosur rrëzimin e kërkesës së Komisionerit për subjektin politik “Aleanca Progresiste LZHK”.

2. Kërkojmë detyrimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të konsideruar të vlefshme rutinë për këshillin bashkiak, Kurbin, Qendra e Votimit nr. 0907, e cila i përket fshatit Shpërdhet, Njësia Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin.

**Baza ligjore:** ‘Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar, ‘Kodi i Procedurave Administrative’, i ndryshuar, Nenet 23 dhe 23/4, pika 1 dhe 4, i ligjit nr.8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar.

me Vendimin Nr. 27, datë 07.06.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, unanimisht,

## VENDOSI

1. Rrëzimin e padisë.
2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

3. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall në Tiranë më datë 07.06.2023.

**Tiranë, më 07.06.2023.**

**Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**